



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2320 prot

Korçë, më 29/12 / 2021

VENDIM

Nr. 656, datë 29.12.2021

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE
ORGANIGRAMËN E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË PËR VITIN
2022

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma ç, si dhe në udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr.27, datë 29.12.2017, "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.12.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative dhe organigramën e Universitetit për vitin 2022, së bashku me relacionin përkatës, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2321 prot

Korçë, më 29/12 / 2021

VENDIM

Nr. 657, datë 29.12.2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES TË SEKTORIT TË STUDIMEVE DHE
SEKTORIT TË TIK

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.12.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2086 prot

Korçë, më 23 / 11 / 2021

VENDIM

Nr. 589, datë 23.11.2021

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE
"FILOZOFI SOCIALE", 120 ECTS NË MASTER I SHKENCAVE "ETIKA DHE
LIDERSHIPI", 120 ECTS**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 42 pika 7, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 20 pika 6, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të MASR, Senati Akademik në mbledhjen online të datës 23.11.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit Master i Shkencave "Filozofi Sociale" 120 ECTS në Master i Shkencave "Etika dhe Lidershipi" 120 ECTS, për departamentin e Shkencave Sociale për vitin akademik 2022-2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2084 prot

Korçë, më 23/ 11 / 2021

VENDIM

Nr. 590, datë 23. 11. 2021

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË
"MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR KL. I-VI" NË "BACHELOR" NË
"MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR"**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 42 pika 7, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 20 pika 6, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të MASR, Senati Akademik në mbledhjen online të datës 23.11.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit "Mësuesi për Arsimin Fillor Kl I-IV", Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" Bachelor, për departamentin e Edukimit për vitin akademik 2022-2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1840 prot

Korçë, më 28/10 / 2021

VENDIM

Nr. 509, datë 28.10.2021

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT AKADEMIK 2021-2022

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, gërma ç, si dhe në urdhrin Nr. 395 prot, datë 06.10.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2021-2022", Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë strukturën e vitit akademik 2021-2022, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1841 prot

Korçë, më 28 / 10 / 2021

VENDIM

Nr. 510, datë 28.10.2021

PËR

MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT I UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË 2022-2027

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 38 pika 1 gërma b, si dhe në Statutin e Universitetit neni 11 pika 3, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2021,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e Planit Strategjik të zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë 2022-2027, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1842 prot

Korçë, më 28/10/2021

VENDIM

Nr. 511, datë 28.10.2021

PËR

MIRATIMIN E FORMAVE TË DIPLOMAVE DHE SUPLEMENTEVE NË TË
GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI",
KORÇË

Në zbatim të nenit 91, pikës 3 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 63 pika 3, të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në Udhëzimin e MASR nr. 11, datë 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës" si edhe në udhëzimin e MASR nr.10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e formave të diplomave dhe suplementeve të përditësuara në të gjitha programet e studimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë që janë:
 - "Diplomë Profesionale" në "Shërbim Social"
 - "Diplomë Bachelor" në "Filozofi-Sociologji"
 - "Diplomë Bachelor" në "Administrim dhe Politika Sociale"
 - "Diplomë Bachelor" në "Teknologji Informacioni"
 - "Diplomë Bachelor" në "Matematikë-Informatikë"
 - "Diplomë Bachelor" në "Matematikë-Fizikë"
 - "Diplomë Bachelor" në "Infermier i Përgjithshëm"
 - "Diplomë Bachelor" në "Mami"
 - "Diplomë Bachelor" në "Biologji-Kimi"

- Diplomë “Master i Shkencave” në “Filozofi Sociale
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësues në Shkenca Sociale”
- Diplomë “Master Profesional” në “Administrim Publik”
- Diplomë “Master Profesional” në “Sistemet moderne të telekomunikacionit dhe teknologjitë e internetit
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësues në Matematikë dhe Informatikë-Fizikë”
- Diplomë “Master Profesional” në “Infermieristikë”
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësues në Biologji-Kimi
- “Diplomë Profesionale” në “Asistent Menaxher”
- “Diplomë Bachelor” në “Biznes dhe Tregti”
- “Diplomë Bachelor” në “Informatikë Biznesi”
- “Diplomë Bachelor” në “Ekonomiks”
- “Diplomë Bachelor” në “Financë-Kontabilitet
- “Diplomë Bachelor” në “Menaxhim”
- “Diplomë Bachelor” në “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje”
- “Diplomë Bachelor” në “Administrim Biznesi në Marketing”
- Diplomë “Master Profesional” në “Bankë dhe Sigurime
- Diplomë “Master Profesional” në “Guidë Turistike”
- Diplomë “Master Profesinal” në “Administrim Biznesi”
- Diplomë “Master Profesional” në “Financë-Kontabilitet
- Diplomë “Master Profesional” në “Marketing”
- Diplomë “Master Profesional” në “Menaxhimi i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve”
- Diplomë “Master Profesional” në “Marketingu Digjital”
- Diplomë “Master i Shkencave” në “Financë”
- “Diplomë Profesionale” në “Mbështetës Zyre për Komunikim Bibliotekë”
- “Diplomë Profesionale” në “Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme”
- “Diplomë Bachelor” në “Histori-Gjeografi”
- “Diplomë Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”
- “Diplomë Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”
- “Diplomë Bachelor” në “Gjuhë Angleze”
- “Diplomë Bachelor” në “Gjuhë dhe Kulturë Frënge”
- “Diplomë Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi”
- “Diplomë Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte”
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësues për Arsimin Fillor”
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësuesi në Histori dhe Gjeografi”
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze”
- Diplomë “Master Profesional” në “Mësues për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
- Diplomë “Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim”
- “Diplomë Profesionale” në “Menaxhim Biznesi Bujqësor”
- “Diplomë Profesionale” në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”
- “Diplomë Profesionale” në “Menaxhim Veterinar”
- “Diplomë Bachelor” në “Agroushqim”

- “Diplomë Bachelor” në “Menaxhim Agrobiznesi”
- “Diplomë Bachelor” në “Inxhinieri Agronomike”
- Diplomë “Master Profesional” në “Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë”
- Diplomë “Master Profesional” në “Cilësia dhe Siguria Ushqimore”
- Diplomë “Master Profesional” në “Zhvillim i Integruar Rural”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI**

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1687 prot

Korçë, më 07/10/2021

VENDIM

Nr. 462, datë 07.10.2021

PËR

PËRSHTATJEN E KUOTAVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të", i ndryshuar, pika 2.7 gërma b) "Në varësi të ecuresisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore", si dhe Udhëzimin nr. 11, datë 2.6.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr 10, datë 15.5.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar", gërma E, pika 4/1, Senati Akademik në komunikimin online të datës 06.10.2021, pas shqyrtimit të propozimeve të njëjësive kryesore,

VENDOSI:

- 1- Rishpërndarjen e kuotave mbështetur në totalin e kuotave të deklaruar nga njësitë kryesore, për programet e studimit si më poshtë:
- 2- Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte", shtohen 5 kuota mbi kuotat e deklaruar, të cilat i zbriten kuotave të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin parashkollor".
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1591 prot

Korçë, më 29/09/2021

VENDIM

Nr. 427, datë 29.09.2021

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT
"BACHELOR"
NË
"STUDIME KULTURORE DHE MEDIA",
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Në zbatim të nenit 38 dhe nenit 73 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" dhe të nenit 11 të Statutit të UNIKO, duke u nisur nga propozimi i Departamentit të Gjuhë-Letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", në komunikimin e përbashkët online të datës 28.09.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për hapjen e programit të studimit, "Bachelor" në "Studime Kulturore dhe Media".
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1592 prot

Korçë, më 29/09/2021

VENDIM

Nr. 428, datë 29.09.2021

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT
"MASTER PROFESIONAL"
NË
"MËSUESI NË ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS",
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Në zbatim të nenit 38 dhe nenit 75 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" dhe të nenit 11 të Statutit të UNIKO, duke u nisur nga propozimi i Departamentit të Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", në komunikimin e përbashkët online të datës 28.09.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për hapjen e programit të studimit, "Master Profesional" në "Mësuesi në Arsimin Gjithëpërfshirës"
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1593 prot

Korçë, më 29/09/2021

VENDIM

Nr. 429, datë 29.09.2021

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT
"MASTER PROFESIONAL"
NË
"MËSUES NË EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET",
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Në zbatim të nenit 38 dhe nenit 75 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" dhe të nenit 11 të Statutit të UNIKO, duke u nisur nga propozimi i Departamentit të Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", në komunikimin e përbashkët online të datës 28.09.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për hapjen e programit të studimit, "Master Profesional" në "Mësues në Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet".
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1594 prot

Korçë, më 29/09/2021

VENDIM

Nr. 430, datë 29.09.2021

PËR
MBYLLJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "MJEKËSI E
BIMËVE DHE HORTIKULTURË", FAKULTETI I BUJQËSISË

Në zbatim të nenit 35 pika 1 dhe nenit 38, pika 1 gërma dh, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" dhe të nenit 11, pika 9 të Statutit të UNIKO duke u nisur nga propozimi i Departamentit të Agronomisë, Fakulteti i Bujqësisë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", në komunikimin e përbashkët online të datës 28.09.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Fakultetit të Bujqësisë për mbylljen e programit Bachelor në "Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë"
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1595 prot

Korçë, më 29 / 09 / 2021

VENDIM

Nr. 431, datë 29.09.2021

PËR
MBYLLJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER I SHKENCAVE"
NË "MJEKËSI E BIMËVE", FAKULTETI I BUJQËSISË

Në zbatim të nenit 35, pika 1 dhe nenit 38, pika 1 gërma dh, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" dhe të nenit 11, pika 9 të Statutit të UNIKO duke u nisur nga propozimi i Departamentit të Agronomisë, Fakulteti i Bujqësisë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", në komunikimin e përbashkët online të datës 28.09.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Fakultetit të Bujqësisë për mbylljen e programit "Master i Shkencave" në Mjekësi e Bimëve".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1526 prot

Korçë, më 21 / 09 / 2021

VENDIM

Nr. 401, datë 21.09.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 71, DATË 10.02.2021,
TË SENATIT AKADEMIK
"PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022
PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË"

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 11, pika 20, si dhe bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018, (I ndryshuar) pika 2.7, gërma a, Senati Akademik pasi diskutoi për propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore në lidhje me kuotat e pranimit për vitin akademik 2021-2022, për programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, në diskutimin online të datës 21.09.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim, tek tabela e kuotave të pranimit, përkatësisht nga një kuotë shtesë tek "Masteri Profesional" "Guidë Turistike" dhe "Turizëm", për vitin akademik 2021-2022 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë kuotat e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1385 prot

Korçë, më 02 / 08 / 2021

VENDIM

Nr. 353, datë 02.08.2021

PËR
MIRATIMIN PARAPRAKISHT TË PROGRAMIT BUXHETOR VJETOR DHE
AFATMESËM PËR PERIUdhËN 2022-2024

Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë i mbledhur në datën 02.08.2021, për miratimin e programit Buxhetor Vjetor dhe Afatmesëm 2022-2024, konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2021-2026, mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ligjit "Për buxhetin e shtetit", të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm" të Ministrisë së Financave, si dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 38 pika h,

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2022-2024 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2021-2026.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1386 prot

Korçë, më 02 / 08 / 2021

VENDIM

Nr. 354, datë 02.08.2021

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO
PROGRAM STUDIMI DHE TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN PARAPRAK
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Mbështetur, në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 për "Miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, në VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", si dhe në VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, pika 1 gërma a), Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.08.2021,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2021-2022 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit të njëjta me vitin akademik 2020-2021.
2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të regjistrimit paraprak 1,600 lekë për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lekë për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lekë për të gjitha programet e dyta të studimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1236prot

Korçë, më 06 / 07 / 2021

VENDIM

Nr. 306, datë 06.07.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PLANET MËSIMORE PËR VITIN
AKADEMIK 2021-2022

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma dh, në Statutin e Universitetit neni 11, pika 9, si dhe në Rregulloren e organizmit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të Universitetit, neni 7 pika 16, Senati Akademik pasi diskutoi propozimet e njëjësive kryesore për ndryshimet në planet mësimore, në mbledhjen e datës 06.07.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në planet mësimore të propozuara nga njësitë kryesore sipas propozimeve bashkëlidhur.
2. Tre departamentet e fakultetit Ekonomik dhe departamenti i Gjuhë-Letërsisë në fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë të paraqesin ndryshimet e nevojshme në planet mësimore deri në datën 30 korrik 2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1237 prot

Korçë, më 06/07 / 2021

VENDIM

Nr. 307, datë 06.07.2021

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIONIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE", DATAVE TË KONKURSIONIT, SI DHE TË TESTEVE PRAKTIKE PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIONIT

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar", si dhe në Urdhrin e përbashkët nr. 6, datë 25.6.2021 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2021-2022", Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.07.2021:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren "Për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Të miratojë datat **19-20 gusht**, si data të konkursit të testeve praktike të kandidatëve për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
3. Sekretaria mësimore brenda datës **6 gusht 2021** afishon në mjediset e fakultetit listën e aplikantëve nga U-Albania dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve në konkurs.
4. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin do të jenë **9-13 gusht**.
5. Në datën **17 gusht** sekretaria mësimore shpall listën e aplikantëve të regjistruar për konkurrim.

6. Miratimin e testeve praktike të konkursit për pranimin e kandidatëve sipas modeleve bashkëlidhur.
7. Raporti i pikëve të fituara në konkurrimin praktik dhe notës mesatare do të jetë **40%** për notën mesatare dhe **60%** për testet praktike.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1238 prot.

Korçë, më 06.07.2021

VENDIM

Nr. 308, datë 06.07.2021

PËR
PËR DISA NDRYSHIME TË VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK NR.
695, DATË 28.12.2020 "PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT TË
RREGJISTRIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË DOKTORATURAVE"

Senati Akademik, në mbledhjen e datës 06.07.2021,

VENDOSI:

Në vendimin nr.695, datë 28.12.2020 të Senatit Akademik, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
1. Të shtyjë afatin e përfundimit të studimeve të doktoraturave, për personelin akademik me kohë të plotë që janë në proces, për një vit, pra deri në qershor të vitit 2022.
 2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:
 3. Për personelin akademik të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, të lidhë kontratat e punës me afat të caktuar sipas përcaktimit të bërë në pikën 1.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1239 prot.

Korçë, më 06.07.2021

VENDIM

Nr. 309, datë 06.07.2021

PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 36 pika 7, neni 38 pika 1, gërma gj, neni 48 pika 1, si dhe në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 11 pika 14, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për anëtar Bordi të Administrimit në mbledhjen e datës 06.07.2021,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë si përfaqësues të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë për një mandat 5-vjeçar, tre kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, si më poshtë:
 1. Eva Dhimitri
 2. Eriseld Kalemaj
 3. Adrian Maho
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1036 prot

Korçë, më 18/06/2021

VENDIM

Nr. 255, datë 18.06.2021

PËR

DHËNIEN E "DIPLOMËS" SHOQËRUAR ME MEDALJEN E ARTË
PROF.DR. ALI JASHARIT

Mbështetur në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 37 pika 3, Senati Akademik i Universitetit, i mbledhur në datën 17.06.2021, pasi shqyrtoi propozimin,

VENDOSI:

1. T'i japë certifikatën "Diplomë", shoqëruar me Medaljen e Artë të Universitetit "Fan S. Noli", Prof.dr. Ali Jasharit me këtë motivacion:

"Për përkushtimin, profesionalizmin dhe dinjitetin me të cilin edukoi breza të tërë në 25 vite veprimtarie të palodhur akademike, për kontributin e sjellë si profesor i shquar i gjuhësisë shqiptare, si autor i veprave madhore shkencore dhe teksteve universitare, dhe për lartësimin e emrit të Universitetit "Fan S. Noli", gjatë periudhës kur ka punuar si drejtues i tij. Në shënjë mirënjohje nga drejtuesit, stafi akademik, dhe studentët e Universitetit "Fan S. Noli". me rastin e 68-vjetorit të lindjes"

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 915 prot

Korçë, më 31/05/2021

VENDIM

Nr. 220, datë 31.05.2021

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 33, pika 2, "Statuti hartohet dhe ndryshohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe aktet nënligjore në fuqi. Ai miratohet nga Senati Akademik i institucionit të arsimit të lartë dhe Bordi i Administrimit. Statuti i dërgohet ministrit përgjegjës për arsimin, i cili brenda dy muajve, kryen kontrollin e ligjshmërisë së tij. Kur konstatohen mospërputhje të tij me ligjin, ministri ia kthen Statutin për ripunim institucionit të arsimit të lartë. Kur ministri nuk ka vërejtje për ligjshmërinë e statudit ose nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, statuti konsiderohet i miratuar. Ndryshimet në statut miratohen me të njëjtat procedura.

Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.5.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, të cilat u kërkuan nga autoritetet drejtuese të Universitetit, (sipas materialit bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 720 prot

Korçë, më 30 / 04 / 2021

VENDIM

Nr. 111, datë 30.04.2021

PËR

NDRYSHIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (PËRFAQËSUESI I STUDENTËVE)

Në mbështetje të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO", neni 6 pika 1, gërma a), Senati Akademik në mbledhjen online të datës 30.04.2021,

VENDOSI:

1. Të ndryshohet si përfaqësues i studentëve Ilija Donaçi, në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, pasi u diplomua në fakultetin Ekonomik në tetor të vitit 2020.
2. Të zgjedhë përfaqësues të studentëve në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, z. Mario Bamllari, student në vitin e tretë, fakulteti Ekonomik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 685 Prot.

Korçë, më 22.04.2021

VENDIM

Nr. 164, datë 22.04.2021

PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMEVE TË NJËSIVE AKADEMIKE ME FINANCIM
NGA TË ARDHURAT E UNIVERSITETIT «FAN S.NOLI», VITI 2021

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika f, në Statutin e Universitetit, neni 11 pika 1, Udhëzimin nr.19, datë 31.5.2011, "Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin "Për kërkim fundamental dhe ekselencë", Senati Akademik në mbledhjen online të datës 22.04.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektpropozimeve sipas kërkesës së Zv.Rektorit për Shkencën dhe Projektet nr.646 Prot., datë 15.04.2021 dhe raportit nr.645 Prot., datë 15.04.2021 të komisionit të ngritur për vlerësimin e projektpropozimeve me urdhër Rektori nr.127, datë 16.03.2021, si më poshtë vijon:
 - "Avantazhet dhe sfidat e zbatimit të vendimmarrjes së mbështetur në të dhëna (Data-driven decision making) për bizneset dhe insitucionet publike pzyr rajonin e Korçës" – Departamenti i Financë-Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë.
 - "Efektet e pandemisë Covid-19 në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale – Bashkia Korçë" – Departamenti i Agrobiznesit, Fakulteti i Bujqësisë.
 - "Shkolla-familja-pushteti vëndor – së bashku në rritjen e cilësisë të të mësuarit dhe të të nxëniet në arsimin e mesëm, Rrethi Devoll" – Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.
 - "Laboratori i krijimit letrar" – Departamenti i Gjuhë - Letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.

2. Ngarkohet Zv.Rektori për Shkencën dhe Projektet, Administratori i Universitetit dhe drejtoritë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 664 prot

Korçë, më 19/04/2021

VENDIM

Nr. 156, datë 19.04.2021

PËR

DHËNIEN E "DIPLOMËS" SHOQËRUAR ME EMBLEMËN E ARTË
AKADEMIKUT PROF.DR. SKËNDER GJINUSHI

Mbështetur në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 37 pika 3, Senati Akademik i Universitetit, i mbledhur në datën 19.04.2021, pasi shqyrtoi propozimin,

VENDOSI:

1. T'i japë certifikatën "Diplomë", shoqëruar me Emblemen e Artë të Universitetit "Fan S. Noli", akademikut, Prof.dr. Skënder Gjinushi me këtë motivacion:

"Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, personalitet i shquar i shkencës shqiptare, profesor i matematikës që ka mëkuar me dashurinë për dijet në këtë shkencë breza të tërë studentësh, për ndihmesat e çmuara që ka dhënë ndër vite institucionit që ai drejton në zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta shkencore dhe drejtime të tjera, në shënjë mirënjohje nga stafi akademik, studentët dhe drejtuesit e Universitetit "Fan S. Noli", me rastin e zhvillimit të tri veprimtarive në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në datën 19.4.2021, si dhe të ndihmesave që ka dhënë ky institucion për organizimin e shumë veprimtarive të tjera në vazhdimësi, për pasurimin e Bibliotekës Shkencore të Universitetit "Fan S. Noli" me një fond prej 400 titujsh veprash shkencore dhe të pasurimit të vazhdueshëm të saj, si dhe të nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 405 prot

Korçë, më 01 / 03 / 2021

VENDIM

Nr. 110, datë 01.03.2021

PËR

NDRYSHIMIN E ANËTARËVE TË NJËSISË PËR SIGURIMIN E
BRENDSHËM TË CILËSISË NË SHKALLË UNIVERSITETI

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 11 pika 17, neni 73 pika 2 si dhe neni 74 pika 1, si dhe sipas përcaktimeve të Manualit të Cilësisë ashtu dhe në propozimet e dërguara nga dekanët e njësive kryesore për përditësimin e listës së anëtarëve të Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në shkallë institucioni, Senati Akademik në mbledhjen e datës 01.03.2021,

VENDOSI:

1. Të përditësojë anëtarët e Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në shkallëUniversiteti, përfshirë dhe studentin, si më poshtë:
 - Dr. Eris Rusi (ndryshon Msc. Olger Brame)
 - Msc. Aldona Minga (ndryshon Prof. as. dr. Gjergji Papa)
 - Dr. Aida Mosko
 - Dr. Maria Dojçe
 - Dr. Evis Kapurani (Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni)
 - Xhovan Saraçi (Drejtorja Ekonomike)
 - Romina Xhaferi (Studente)
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI

Prof.dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 406 prot

Korçë, më 01 / 03 / 2021

VENDIM

Nr. 111, datë 01.03.2021

PËR

MIRATIMIN E ZËVENDËSREKTORIT PËR MËSIMIN

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionit e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40 pika 2, si dhe në Statutin e Universitetit neni 13 pika 13, si dhe neni 14 pika 2, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, i mbledhur në datën 01.03.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Rektorit të Universitetit "Fan S. Noli", për emërimin e Dr. Arto Adili, si zëvendësrektor për Mësimin.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 295 prot

Korçë, më 10 / 02 / 2021

VENDIM

Nr. 70, datë 10.02.2021

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E
PARË TË STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 pika 8, neni 74 pika 2, neni 76 pika 3, si dhe në shkresën nr. 51 prot, datë 6.1.2021 "Për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023", pasi diskutoi propozimet e departamenteve në lidhje me kriteret e pranimit në programet e studimit për vitin akademik 2022-2023, Senati Akademik në diskutimin online të datës 10.02.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit për vitin akademik 2022-2023, sipas propozimeve përkatëse të departamenteve.
2. Ti përcjellë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë kriteret e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 296 prot

Korçë, më 10 / 02 / 2021

VENDIM

Nr. 71, datë 10.02.2021

PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022
PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 11, pika 20, si dhe bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018, (i ndryshuar) pika 2.7, gërma a, Senati Akademik pasi diskutoi për propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore në lidhje me kuotat e pranimit për vitin akademik 2021-2022, për programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, në diskutimin online të datës 10.02.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit për vitin akademik 2021-2022 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë kuotat e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello

